

Parandalimi dhe adresimi i korrupsionit në sistemin e burgjeve

Hyrje

Ky udhëzues është një material ndihmës për të bërë me dije të dënuarin/të paraburgosurin dhe personelin e burgjeve mbi parandalimin, identifikimin dhe adresimin e akteve korruptive në sistemin e burgjeve.

Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit trajtohen disa çështje që lidhen me antikorrupsionin, të cilat përcaktojnë:

- a. *Neni 5* (1) Çdo shtet duhet, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor, të zhvillojë dhe zbatojë, politikat përkatëse kundër korrupsionit, duke nxitur pjesëmarrjen e shoqërisë për një menaxhim efikas të punëve publike përmes integritetit, transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve;
- b. *Neni 8* (1) Për të luftuar korrupsionin çdo shtet duhet të promovojë integritet, ndershmëri dhe përgjegjshmëri tek zyrtarët e institucioneve, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor. Në veçanti, çdo shtet duhet të përpiqet të zbatojë, në institucionet publike, kodet ose standardet që përcaktojnë rregullat e sjelljes për kryerjen në mënyrë të duhur dhe të ndershme të funksioneve publike.

1. Çfarë kuptojmë me korrupsion?

Korrupsioni është një fenomen kompleks, po aq sa është i vjetër. Termi korrupsion rrjedh nga fjala latinishtje “*corruption*”, që nënkupton “*degradim moral*”. Koncepti mbi korrupsionin përgjithësisht ndryshon sipas kontekstit, prandaj është e vështirë të përcaktohet një term i vetëm bashkëkohor, për shkak të dimensioneve të shumta të tij. Zakonisht në kontekstin publik, korrupsioni përkufizohet si një akt antiligjor, që lidhet me abuzimin e pushtetit dhe besimit publik për përfitime personale. Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) e lidh korrupsionin me korrelacionin ndërmjet koncepteve të tilla, si: pushteti, përgjegjshmëria, liria e veprimit, integriteti dhe transparenca¹.

Korrupsioni është një problem universal që afekton funksionimin e administratës publike dhe të drejtat e grupeve më vulnerabël të shoqërisë, në veçanti të drejtat e

¹ United Nations Development Program (2004), Anti-Corruption Practice Note, UNDP
http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf

personave me liri të kufizuar, duke përforcuar përjashtimin, diskriminimin dhe arbitraritetin. Ekzistojnë tri koncepte që trajtojnë mënyrën sesi korrupsioni afekton të drejtave të njeriut: korrupsioni i drejtpërdrejtë, jo i drejtpërdrejtë dhe me ndikim të largët².

Korrupsioni është një problem global. Në shumë raste kompleksiteti i korrupsionit në sektorë të ndryshëm kërkon një analizë të thellë për të kuptuar më mirë shkaqet dhe pasojat, por edhe për të mësuar apo eksploruar zgjidhje të reja.

2. Çfarë përbën një akt korruptiv?

Referuar Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Kapitullit VIII “Krimet kundër autoritetit të shtetit”, nenet 244, 245, 245/1, 248 e në vazhdim deri në nenet 259 dhe 260, përcaktohet qartë se çfarë është korrupsioni, në çfarë formash shfaqet ai dhe si e përcakton ligji dënimin për këto vepra penale.

Në tërësi, një akt korruptiv quhet i tillë kur realizohet në disa parakushte:

- Sjell përfitime materiale, monetare apo morale për persona të caktuar, që kanë lidhje me aktin korruptiv ose për një palë të dytë apo të tretë, që ndërvaret nga veprimi i kryer;
- Favorizon një palë nëpërmjet diskriminimit/ abuzimit/ shfrytëzimit të një pale tjetër;
- Kur kryhet me qëllim, duke planifikuar rrugën që do të ndiqet dhe pa mbajtur parasysh pasojat që do të sjellë, kemi të bëjmë me korrupsion aktiv. Personi apo personat veprojnë që ta nxisin apo që ta bëjnë të mundur aktin korruptiv;
- Në rast të mosveprimit në përmbushjen e detyrave funksionale, detyrimeve ligjore dhe zbatimit të rregullores së institucionit kemi të bëjmë me korrupsion pasiv.
- Në rast të moskallëzimit të aktit korruptiv, me apo pa arsye, quhet bashkëpunim në veprën penale të korrupsionit. Personi apo personat nuk veprojnë që ta ndalojnë apo pengojnë aktin korruptiv;
- Shoqëria civile, sektori privat dhe media luajnë rol jetësor në këtë aspekt.

3. Format me të cilat shfaqet korrupsioni

Korrupsioni mund të shfaqet në shumë forma. Ai mund të jetë:

- 1) ***I dukshëm*** ose i përditshëm dhe në këtë rast duket në fenomenet e zakonshme të jetës, në veprimet transaksionale që kryejmë (shit- blerje, transferimi bankar i parave, depozitimi i të ardhurave etj.) dhe në dhënien ose jo të prioritetit ndaj gjërave të caktuara.

² Adugna Gebeye, B.: Corruption and Human Rights: Exploring the Relationships, 2012, f.9 .
<http://www.du.edu/korbel/hrhë/ëorkingpapers/2012/70-gebeye-2012.pdf>

- 2) *I fshehur* ose në thellësi dhe përfshin punën e politikanëve, zyrtarëve, që kanë të drejtë të ndërhyjnë në fondet publike. Këtu përfshihen edhe veprat e korrupsionit në nivelin e forcave të sigurisë, të cilat mund të çenojnë sigurinë ndërkombëtare.
- 3) *I padukshëm*, që ka të bëjë me politikë-bërjen, ose thënë ndryshe politikat që ndërmerren, por që nuk kryhen, me qëllim përfitimin monetar apo material.

Në rastin e sistemit penitenciar mund të themi se dy janë format kryesore të ndikimit të korrupsionit në të drejtat e personave me liri të kufizuar: ndikimi i drejtpërdrejtë dhe ndikimi jo i drejtpërdrejtë. Korrupsioni me ndikim të drejtpërdrejtë, afekton të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke çenuar parimin e barazisë, paanshmërisë dhe mosdiskriminimit dhe duke privuar aksesin e tyre në këto të drejta. P.sh. një ryshfet i dhënë kundrejt një favoriti siç mund të jetë ndryshimi i dhomës, përfitimi i trajtimit mjekësor apo përfitimi i një leje të veçantë. Korrupsioni me ndikim jo të drejtpërdrejtë, po ashtu, ka ndikim në të drejtat e personave me liri të kufizuar, kur ekziston një kusht për çënimin e të drejtave të kësaj kategorie. Një rast mund të jetë p.sh. korrupsioni në tendera, që ndikon në të drejtën e kategorisë së personave me liri të kufizuar për të përfituar shërbime cilësore dhe sipas standardeve.

Qasjet teorike bashkëkohore mbi korrupsionin me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e personave me liri të kufizuar në sistemin penitenciar, mbështeten në dy aspekte kryesore organizative. Sipas studiuesit Herman Golstein³, këto qasje përpiqen të shpjegojnë arsyet e lindjes së korrupsionit në sistemin penitenciar.

Rregullat e organizimit

Kjo qasje ka të bëjë me faktin se si janë përcaktuar, komunikuar dhe kuptuar rregullat e organizimit dhe të funksionimit të institucionit nga administrata e burgut. Këto rregulla përcaktojnë, ndër të tjera, edhe aspekte të tilla të sjelljes, si: pranimi i dhuratave të vogla, vakteve të ushqimit apo favoreve të tjera.

Mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit

Një dimension i dytë i lidhur me korrupsionin në sistemin penitenciar ka të bëjë me mekanizmat për parandalimin dhe kontrollin. Mekanizma të rëndësishme të parandalimit dhe kontrollit janë: edukimi dhe trajnimi mbi etikën, si dhe monitorimi dhe hetimi proaktiv e reagues i akteve korruptive⁴. Sipas kësaj qasje, niveli i zbatimit të këtyre mekanizmave ndikon ndjeshëm në nivelin e korrupsionit.

Sipas studiuesve, ekziston edhe një dimension i tretë i korrupsionit në sistemin penitenciar, që ka të bëjë me ndikimin e faktorëve socialë, ekonomikë, politikë, në të

³ U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice “The Measurement of Police Integrity”

<file:///C:/Users/User/Desktop/Prison%20corruption.pdf>

⁴ Hetimi reaktiv ka të bëjë me reagim/ kundërpërgjigje pas kryerjes së aktit (korruptiv), ndërkohë hetimi pro-aktiv ka të bëjë me kundërpërgjigje përpara kryerjes së aktit (korruptiv), për ta parandaluar atë.

cilat funksionon sistemi në tërësi. Sipas kësaj qasje, pritshmëritë e publikut mbi sjelljen dhe integritetin e punonjësve të sistemit penitenciar luajnë rol në performancën e tyre. Besohet se në vendet ku ka presion të lartë të publikut kundër akteve korruptive, performanca e punonjësve të sistemit penitenciar është më pozitive, krahasuar me vendet ku presioni është i ulët.

4. Procese të punës që mund të gjenerojnë korrupsion në sistemin penitenciar

Sistemi penitenciar është mjaft vulnerabël ndaj korrupsionit, kjo e lidhur ngushtësisht me vetë natyrën e punës. Ai duhet të rehabilitojë personat në konflikt me ligjin, të garantojë jetën e tyre brenda institucionet ku vuajnë dënimin dhe të respektojë të drejtat që u njeh ligji.

Dinamika e madhe që prodhojnë burgjet çdo ditë, bën që krahas punës së mirë të ketë edhe fiktivitet apo problematika, të cilat lidhen direkt apo indirekt edhe me elementet e korrupsionit.

Puna joefektive në sistemin penitenciar është e perceptuar jo vetëm si veprim apo mosveprim kundrejt një akti korruptiv, por edhe në kuptimin e një pune jo korrekte dhe ofrimin e standardeve të ulëta në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë dhe trajtimit human të personave me liri të kufizuar, pa abuzuar me pozitën e tyre si të burgosur apo me kufizimet që kanë në denoncimin e korrupsionit.

Proceset e punës që kanë lidhje direkt ose indirekt me elementet korruptive në sistemin penitenciar, janë:

Vlerësimet e Sektorit Social

Janë evazive për rastet kur të burgosurit mund të përfitojnë leje shpërblyese e të veçanta, si dhe kur janë për përfitimin e dënimeve alternative të Shërbimit të Provës dhe i drejtohen gjykatës. Për të shmangur abuzimet e këtij sektori, duhet që:

- Të parandalohet korrupsioni i punonjësve socialë për ta 'zbardhur' dosjen, duke hequr masat disiplinore të dhëna ndaj të burgosurve;
- Në formularin drejtuar gjykatës përkatëse, informacioni të jetë përshkrues dhe i detajuar për çdo të burgosur, që të ndihmojë dhe jo pengojë (me apo pa qëllim) procesin.

Planifikimi i lejeve

- Duhet të jetë një proces transparent, ku të dënuarit të njoftohen paraprakisht për lejen e tyre. Kjo parashikohet edhe nga Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë për lejet shpërblyese e të veçanta, ku kërkohet që të afishohet çdo fillim muaji tabela e lejeve të muajit përkatës, pa përcaktuar datat e lejeve apo veprën penale të të burgosurve.

- Një rrezik i mundshëm është favorizimi i personave të caktuar në dhënien e lejeve dhe disfavorizimi i të tjerëve. Në këtë kuptim, duhet të respektohen afatet ligjore dhe të merren parasysh të dhënat e dala nga raporti i Vlerësimit të Sjelljes.

Aplikimet për lirimet me kusht

T'u ofrohet asistencë ligjore të burgosurve, duke vendosur kontakt të drejtpërdrejtë të punonjësit e Sektorit Ligjor me të dënuarit. Të regjistrohen kërkesat e të dënuarve dhe të informohet drejtoria.

Shërbimi shëndetësor

- Mjekët duhet të mbajnë marrëdhënie të mira dhe të ndershme me njëri- tjetrin dhe me anëtarët e tjerë të personelit mjekësor, duke respektuar pavarësinë profesionale të secilit, në interes të të sëmurëve dhe ruajtjes së emrit të mirë të profesionit dhe institucionit mjekësor.
- Mjeku edhe jashtë ushtrimit të profesionit duhet të ruajë të pastër figurën e tij morale, duke shmangur çdo akt që do të zhvlerësonte personalitetin dhe dinjitetin e tij njerëzor e profesional.
- Mjekut në asnjë rast nuk i lejohet të abuzojë me prioritetet dhe avantazhet që i krijon statusi i tij profesional ndaj të sëmurit, për qëllime përfitimi personal dhe profesional.
- Mjeku duhet të sigurojë transparencën më të lartë dhe e ka të ndaluar të shfrytëzojë funksionin për përfitime të tjera personale të kundërligjshme.
- Çdo abuzim, mashtrim ose falsifikim i dokumenteve mjekësore, është i dënueshëm.
- Çdo pasaktësi dhe mospërputhje me konstatimet mjekësore dhe abuzimi në përshkrimin dhe lëshimin e dokumenteve mjekësore, duhet të përbëjë objekt ndjekje dhe përballje me proceset e gjykimit disiplinor profesional dhe juridik për personat përgjegjës.
- Mjeku është i detyruar të mos heshtë dhe të mos qëndrojë indiferent përpara gabimeve apo akteve korruptive, që mund të bëhen nga bashkëpunëtorët ose personeli tjetër ndihmës.

Shërbimi i sigurisë

Praktika e deritanishme ka treguar se disa punonjës pa integritet bëhen bashkëpunëtorë me të dënuarit në futjen e sendeve të ndaluara, në përpjekjet për arratisje, në përfitime të paligjshme etj.

Disa veprime korruptive të punonjësve të policisë, janë si vijon:

- Moskërkesë të barabartë në zbatimin e detyrimeve që kërkojnë ligjet e rregulloret që normojnë punën e punonjësve të policisë në Institucion;

- Futja në takim e personave jo sipas rregullave (lidhja familjare), pa dokumente ose me dokumente të paverifikuara;
- Regjistrim të personave e futje të tyre jashtë rradhe, kundrejt pagesave apo favore të tjera;
- Mosrespektim i numrit të takimeve që përcaktohet sipas rregullores;
- Mosrespektim të sasisë së lejuar të normave të ushqimit;
- Kryerja e takimeve në ambiente të pamiratuara;
- Shkelje të procedurave të kontrollit e të evidentimit të pajisjeve elektroshtëpiake të të dënuarve e të paraburgosurve;
- Kryerja të kontroleve të përcipta gjatë hyrje- daljeve e lëvizjeve të ndryshme, sidomos të titullarëve të institucionit, por edhe disa familjarëve “të përkedhelur” apo të dënuarve që kthehen nga leja;
- Gjetja dhe mosevidentimi i sendeve të ndaluara ndaj personave të quajtur “VIP”;
- Mosprangosja e disa të dënuarëve e paraburgosurve gjatë lëvizjes për në spital apo gjykata;
- Lëvizjet për në spital me rekomandime të ndryshme (ndërhyrje);
- Favorizim në sistemimin në dhoma;
- Lejimi i ajrosjeve të zgjatura me pretekse të ndryshme shëndetësore;
- Diskriminim racial e fetar.

Pritja e qytetarëve

Familjarët hasin në vonesa dhe shpesh japin ryshfet për të hyrë jashtë radhe në takim me të afërmit e tyre, që janë të burgosur. Për këtë arsye, duhet një monitorim më i madh i stafit tek seksioni i takimeve.

Punësimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve

Punësimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP, duhet të bëhet mbështetur në kritere të përcaktuara qartë, si: mosha, aftësia për punë, profesioni, vlerësimi i sjelljes etj, në mënyrë që të shmangët abuziviteti.

5. Anti- korrupsioni

Janë disa mekanizma për të reaguar ndaj korrupsionit, si psh. të distancohesh nga aktet korruptive ose personat që e kryejnë atë, ta refuzosh korrupsionin në çdo formë që ai shfaqet, ta denoncosh në organet kompetente shtetërore e të pavarura etj.

Mënyra më efikase për të reaguar ndaj korrupsionit mbetet denoncimi i tij.

- Ju mund të denonconi përmes formularit tek seksioni “Stop Korrupsionit në Drejtësi”, në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku duhet të jepni qartë të dhënat dhe faktet që doni të denonconi;
- Gjithashtu, tek seksioni “Kontakte” mund të dërgoni e-mail në një prej drejtorive të Ministrisë së Drejtësisë;
- Ju mund të denonconi përmes e-mailit zyrtar të DPB: *info@dpbsh.gov.al*
- Ose përmes telefonatave në numrin pa pagesë: 08002080
- Si dhe përmes mekanizmit të kërkesë- ankesës (formulari “Ankesë mbi një akt korruptiv”).

Kujt mund t’i drejtoheni me kërkesën ose ankesën tuaj?

Neni 8 i Ligjit nr. 8328, datë 16.02.1998, i ndryshuar, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve” garanton se “...Kërkesat dhe ankesat duhet t’i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por të burgosurit kur e çmojnë me vend mund t’i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizate joqeveritare brenda dhe jashtë vendit”. Më tej ky ligj, në nenin 49 të tij, sanksionon se “Pas pranimit në institucion, i paraburgosuri dhe i dënuari informohen nga komisioni i pritjes lidhur me të drejtën për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtimisht me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe të huaja, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin....”

Ju mund t’i drejtoheni me ankesë edhe institucioneve të tjera brenda apo jashtë sistemit të burgjeve, të tilla si: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, si dhe inspektorët e shërbimit të kontrollit të brendshëm të burgjeve.